



Termet e referencës

Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon (me poshte Unioni) është një bashkim vullnetar, i lirë dhe i pavarur i Komunave të: Prishtinës, Preshevës, Prizrenit, Tetovës, Çairit, Gostivarit, Ulqinit, Tuzit dhe Bashkisë së Tiranës. Ajo është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, joqeveritare e formës Shoqatë.

Shoqata me emrin UBSHR është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 29.07.2019 me Nr. vendimi 6305. Regjistrim i saj është në përputhje me Ligjin Nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” dhe sipas Ligjit Nr. 8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” me nr NIPT L92006451C.

Qëllimet kryesore të UBSHR janë:

- Të krijoje një platformë bashkëpunimi që do t'u lejojë bashkive/komuna anëtare të intensifikojnë shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës në fushat e urbanistikës, inovacionit, mjedisit, kulturës dhe formave të reja të financimit;
- Të ngreje një Grup të Përhershëm Koordinator që ka për detyrë të ndërmjetësojë në mënyrë të pandërprerë komunikimin dhe bashkëpunimin konkret mes bashkive/komuna anëtare për të gjitha fushat me interes;
- Të zhvilloje shkëmbime të rregullta ekspertize, përvoja dhe projektesh që kanë rezultuar të suksesshme;
- Të krijojë rrjetëzimin e bizneseve në rajonin shqipfolës.
- Të zhvilloje rregullisht programe të përbashkëta kulturore e artistike;
- Të punoje për thithjen e fondeve dhe projekteve rajonale dhe ndërkufitare;

Përmes një aplikimi të suksesshëm në Ambasadën Amerikane në Shqipëri, në fondin e Small Grants for Democracy, UBSHR do të implementojë projektin WORD (WOMEN ON RURAL DEVELOPMENT).

Projekti WORD (Gratë në Zhvillim Rural) do të kontribuojë në fuqizimin e 100 grave në gjashtë njësi administrative të Tiranës, përmes njohurive në zinxhirin agroturistik, duke përmirësuar situatën e tyre ekonomike dhe duke siguruar ndërtimin e kapaciteteve.

Trajnimet, mentorimet, shkëmbimi i përvojave, janë teknikat e propozuara për këtë projekt, duke iu mundësuar grave dhe vajzave njohurite e dhura për ta bërë turizmin një biznes fitimprurës. Projekti i propozuar do t'u japë grave mundësi për të rritur njohuritë, për ti informuar rreth mundësive të aksesimit të tregut dhe e gjithë kjo do të çojë në përmirësimin e situatës ekonomike të grave dhe fuqizimin e tyre shoqëror.

Për këtë arsye, lind nevoja e ngritjes së një grupi ekspertësh me backgrounde të ndryshme në mënyrë që të japin ekspertizën në trajnime/mentorime e tyre për gratë pjesëmarrëse në projekt, konkretisht:

1. Eksperte në ofrimin e këshillimit në shërbimet e biznesit
2. Eksperte në ngritjen e kapaciteve për zhvillim dhe modelim biznesi
3. Eksperte në ofrimin e shërbimeve të mikpritjes dhe rritjen e vlerës në zinxhirin e turizmit
4. Ekspert në edukimin financiar dhe lehtësimin e aksesit në financë
5. Eksperte në fushën e trashëgimisë kulturore
6. Eksperte e zhvillimit të produkteve e strategjive të marketingut të turizmit
7. Ekspertë në fuqizimin ekonomik dhe social, në aftësitë e lidershit dhe menaxhimit
8. Ekspert ligjor në sektorin e zhvillimit të turizmit rural

1. Kualifikimet minimale të ekspertëve

- Diploma bachelor/ master në fushat e turizmit, sektorit të mikpritjes, bujqësisë, ekonomisë apo disiplina të ndryshme të lidhura ngushtë me fokusin e trajnimeve;
- Përvojë pune disavjecare e dëshmuar në turizmin rural;
- Eksperienca të mëparshme si trajnerë/mentorë në seminare/workshope të ndryshme janë aset.
- Aftësi për të punuar në ekip;
- Përvojë në përgatitjen e raporteve, dokumenteve të ndryshme;
- Njohja e tendencave aktuale në zhvillimin rural me një fokus të veçantë në turizmin rural;
- Njohuri ekzistuese mbi tendencat aktuale të zhvillimit rural/turizmit rural në Ballkanin Perëndimor do të ishin avantazh;
- Njohuri të kompjuterit dhe paketës Office si dhe aftësi të avancuara të shkrimit dhe të folurës në publik.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

2. Nënshkrimi i Kontratës

Unioni njofton ekspertët e përzgjedhur, me ane të komunikimit me email, brenda 3 ditëve pune nga marrja e vendimit. Brenda 5 ditëve nga njoftimi i ekspertëve të përzgjedhur, nënshkruhet kontrata me çdo individ, ku saktësohen të drejtat dhe detyrimet reciproke të palëve.

3. Pagesa

Fondi i parashikuar është në vlerë totale (bruto) të kontratës prej \$300/ekspert, për çdo aktivitet. Në këtë vlerë përfshihet puna përgatitore para trajnimit, pjesëmarrja dhe dhënia e trajnimit si dhe përgatitja e raporteve të kërkuara brenda afateve kohore. Të gjitha kostot e përgatitjes së materialeve para dhe pas trajnimit, janë detyrim i ekspertit.

Vlera e kontratës është bruto dhe përfshin detyrimet financiare në fuqi sipas ligjit shqiptar (vlerë e cila deklarohet nga UBSHR-ja).

4. Materialet që kërkohen nga ekspertët dhe raportimi

- Të zhvillojnë planin për trajnimet dhe pikat e diskutimit në bashkëpunim me koordinatorin e trajnimeve.
- Dhënia e ekspertizës gjatë aktivitetit me detyrat e caktuara si në kontratë.
- Raport përmbledhës të zhvillimit të aktivitetit.
- Raport përfundimtar me propozimet, rekomandimet e tyre për gratë dhe vazjat pjesëmarrëse në projekt brenda 10 ditëve nga zhvillimi i aktivitetit.
- Gjatë kohës së përgatitjes së raporteve, ekspertët do mbajnë kontakt të vazhdueshëm me stafin e projektit për të marrë në konsideratë komente dhe sugjerime nga ana e tyre, apo kërkesa të tjera.

5. Vendi i zhvillimit të trajnimeve

Vendi i zhvillimit të trajnimeve është në Tiranë.

6. Kohëzgjatja

Detyrimet hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës. Ekspertët duhet të përgatiten paraprakisht për ditën e zhvillimit të trajnimit si dhe maksimalisht 10 ditë pas përfundimit të tij, të realizojnë raportin përmbledhës me pikat e diskutuara dhe sugjerimet/rekomandimet e tyre. Kontrata përfundon në datën e kryerjes së detyrimit ndaj të kontraktuarve.

7. Gjuha e kërkuar

Gjuha në të cilën do të punohet është Shqip, por kërkohet njohuri shumë të mira dhe në gjuhën angleze.

8. Emri dhe Adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri : UNIONI I BASHKIVE SHQIPTARE NË RAJON;

Adresa : Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës, Kati 2, Zyra 18, Tiranë;

E-mail : ubshr@tirana.al